



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 16

Datë: 15. 05. 2019. Ora: 10:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë.

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ.

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Florian Dushi, Adnan Rrustemi, Nazlije Bala, Ercan Spat, Alfred Kinolli, Čemailj Kurtišti.

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ.

Përkthyes: Vera Dula. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ-së nr. 15 /2019

2. Aktivitetet e ZRPP-së:

- Rekomandim për akreditim të vëzhguesve:

3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Objektivave të KE-së
4. Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimeve të KVV-ve
5. Raporti i Këshillave të KQZ-së:

Këshilli për Çështje Ligjore:

Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimit të anëtarit të kuvendit komunal në Vushtrri.

6. Të ndryshme.
-

1. Hyrie: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ-së nr. 15 /2019

Valdete Daka: E hapi mbledhjen e 16-të, kemi kuorum... A ka dikush vërejtje në pikat e rendit të ditës ? Nëse jo, kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës, dhe pastaj miratuan edhe procesverbalit të mbledhjes së KQZ-së nr. 15/2019.

2. Aktivitetet e ZRPP-së

Rekomandim për akreditim të vëzhguesve:

Valmira Selmani, u.d. e ZRPP: Zyra ka proceduar me rekomandimin për akreditim të vëzhguesve dhe në bazë të ligjit 54.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, të nenit 19 të ligjit për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenit 3 të Rregullës Zgjedhor 07/2013 për Vëzhguesit e Zgjedhjeve, si dhe në bazë të planit operacional, zyra ka proceduar kërkesat për akreditim të vëzhguesve të dy partive politike, të dy misioneve ndërkombëtare, të Komisionit Evropian, të dy misionet diplomatike, të 12 ambasadave, të një OJQ-je ndërkombëtare, të 4 OJQ-ve vendore, të 15 mediave me gjithsej 464 vëzhgues. Kushtet për t'u akredituar si vëzhgues, kanë plotësuar të gjitha subjektet politike si dhe organizatat e tjera të cilat i kanë dorëzuar aplikacionet në zyrë. Është bërë verifikimi i tyre, dhe zyra rekomandon KQZ -n që ti akreditoj vëzhguesit për zgjedhjet e jashtëzakonshme të datës 19.05.2019, Në tabelë, i keni emrat e subjekteve politike, të ambasadave dhe informacionet e tjera.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan akreditimin e këtyre vëzhguesve.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimeve të KVV-ve

Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ: Ne, e kemi pranuar një kërkesë për tërheqjen e disa komisionarëve në komunën e Leposaviçit. E keni listën e bashkangjitur se cilët komisionar do të tërhiqen, dhe po ashtu, një konfirmim se cilët do të jenë nga ky subjekt politik, e ata tashmë janë të miratuar dhe, kërkohet ndoshta miratim vetëm sa për tërheqjen e këtyre që i kanë listuar, e të cilët i keni në material.

Adnan Rrustemi: Kjo nuk është pikë e rendit të ditës. Pikë e rendit të ditës, është zëvendësimi i 20 të tjerëve sepse, ata që janë tërhequr janë tërhequr, dhe ne nuk kemi se çka me miratuar tërheqje..., s'ka zëvendësime...Në rastin konkret, i kemi 20 emra të tjera të cilët janë larguar nga subjektet e ndryshme dhe janë zëvendësuar po nga të njëjtat subjekte politike. Këto, duhet me i miratuar, ndërkohë, njoftimi është sikur i tërhequr një subjekt politik...

Stevan Veselinoviq: Unë nuk kam material, kam material vetëm për Mitrovicën Veriore.

Valdete Daka: Nuk kemi tjetër material, kemi materiale vetëm për Mitrovicën veriore...

Florian Dushi: E kemi edhe një pjesë tjetër të tërhequr të një subjekti të veçantë, çka ka ndodhur me ta, a janë zëvendësua ata...?

Valdete Daka: Ata vetëm janë tërhequr...

Florian Dushi: A do të dërgojmë emra për zëvendësime, sepse si përbërje ne e kemi një formulë...!

Adnan Rrustemi: Mendoj që ishte dashur të njoftohen anëtarët e KQZ-së zyrtarisht, me përbërjen e re të KVV-ve në rastin konkret...

Valdete Daka: A bënë me e dërgua listën me emra të atyre që janë tërhequr...!

Florian Dushi: Ne sot po i aprovojmë këto zëvendësime sepse këta duhet me u emëruar prej KQZ-së dhe se, pa miratim të KQZ-së nuk mundet askush me qenë anëtar i Këshillit të Vendvotimit. Ndërkohe, ne duhet me u njoftuar me një raport të veçantë lidhur me atë se çka ka ndodhur në një komunë tjetër d.m.th., me vete faktin e tërheqjes dhe, pas kësaj kësaj tërheqje si duken tabelat e reja të KVV-ve pas kësaj tërheqje...

Valdete Daka: Le të na dërgohen emrat e atij subjekti politik dhe lista e KVV-ve të ndryshuar. Ndërkaq, e kemi Mitrovicën e veriut: janë 10 komisionar të cilët janë zëvendësuar me 10 komisionar të tjerë nga po i njëjti subjekt...

Anëtarët e KQZ-së, miratua zëvendësimin e 10 komisionarëve.

4. Raporti i Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Çështje Ligjore

Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimit të anëtarit të kuvendit komunal në Vushtrri:

Florian Dushi: Këshilli ka mbajtur sot kemi në të cilin është shqyrtuar kërkesa për zëvendësimin e një asamblisti në Asamblenë Komunale të Vushtrrisë, i cili ka dhënë dorëheqje. Arsyet, janë cekur në dorëheqjen e tij. Bëhet fjalë për z. Qerimi Selimi, i cili zëvendësohet nga Selim Rrustemi nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës. Sekretariati, po edhe këshilli ka shqyrtuar gjithë dosjen e përpiluar për këtë zëvendësim dhe se është konstatuar se gjithçka është në rregull.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë zëvendësim të Asambleistit Komunal.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Objektivave të KE-së

(Kjo pikë e rendit të ditës, është shqyrtuar vetëm nga anëtarët e KQZ-së)